



Shkolla e Mesme e Lartë Gjimnazi "Naim Frashëri" Shtime
Institucioni i Arsimit dhe Aftësimi Profesional Shtime

Data	11.09.2023
Nr.	183/23
Nga	Zejnepe Hysenaj - Drejtore e shkollës Labinot Rexhaj - Drejtor shkolle në IAAP
Lënda	FTESË PËR OFERTË

Duke u bazuar në Nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, Gjimnazi "Naim Frashëri" në Shtime, dhe Institucioni i Arsimit dhe Aftësimi Profesional IAAP shpall këtë:

FTESË PËR OFERTË

Gjimnazi "Gjimnazi "Naim Frashëri" në Shtime, dhe Institucioni i Arsimit dhe Aftësimi Profesional IAAP , organizon ekskursionin e maturantëve të vitit shkollor 2023/2024 në relacionin Kosovë - Shqipëri. Ftohen operatorët ekonomikë për parashtrimin e ofertave përkatëse, duke ju përmbajtur kushteve të kësaj oferte dhe itinerarit të caktuar nga KDSH.

I. Informata të përgjithshme

1. Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës më dt. 11.09.2023 deri më dt. 17.09.2023 deri në ora 14: 00;
2. Ofertat e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin për nxënës, të transportit për relacionin e caktuar nga shkolla (shih më posht itinerarin);

3. Çështje të tjera specifike përcaktohen në kontratën midis autoritetit kontraktues (shkolla) dhe operatorit ekonomik;
4. Operatorët ekonomikë (agjencia) duhet të përmbahen të gjitha obligimeve që përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore dhe të gjitha akteve tjera ligjore/nënligjore përkatëse.

II. Kushtet

1. Operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë kushtet sipas shtojcës A nga UA (MASHTI) , nr. 02/2016. Shtojca 2 Forma B (Transporti);
2. Lirimi nga pagesa për nxënës me kushtet e vështira ekonomike dhe familjar të të njëjtës familje (%)

III. Dokumentet e kërkuara

1. Leja e punës së OE;
2. Certifikatën dhe informatat e biznesit së OE;
3. Vërtetimi tatimor nga ATK;
4. Librezat e të gjithë autobusëve të OE;
5. Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve;
6. Dëshmi e komfortit/klimës së autobusëve;
7. Certifikata shëndetësore e ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
8. Diploma dhe Kontrata e punës së mjekut;
9. Lista e ngasësve me licencën D për transport;
10. Dëshmi tjera të ekskursioneve përkatëse;
11. Deklarata për lirim nga pagesa për nxënës me kushte të vështira ekonomike, nxënës vëlla e motër;

IV. Dorëzimi i dokumenteve

1. Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës për ofertë më dt. 12. 09. 2023 deri më dt. 17. 09. 2023 deri në ora 14:00;
2. Aplikimi dhe dorëzimi I dokumenteve bëhet me zarf të mbyllur në objektin e komunës në DKA;
3. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje të noterizuara;
4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
5. Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
6. Pala e paknaqur mund të bëjë ankesë deri më datën deri në ora 15:00.

V. Të dhënat e shkollës/kërkesa për aktivitetin

Numri i nxënësve nga gjimnazi është prej 210 deri 227, ndërsa nga IAAP prej 120 deri 140 që këtë aktivitet do ta zhvillojnë bashkërisht.

Qëndrimi në Shqipëri do të jetë tre (3) netë e katër (4) ditë.

Itinerari i paraparë për realizim është si vijon:

Dita parë 19 shtator 2023;

- Ora 7:00 nga Shtimja bëhet nisja për Shqipëri.
- Vizitë qytetit të Lezhës (te varri i Skënderbeut), duke vazhduar më pas në Shkodër. Dreka duhet të jetë në qytetin e Shkodrës, sasia e ushqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës nga kompania kontraktuese. Më pas vizitë Pedonales së qytetit. Në ofertë të jenë të specifikuar menyuja që ofron. Vizitë Kalas së Shkodrës.
- Kthimi në hotel në Durrës dhe sistemimi nëpër dhoma gjumi. Dhomat të pajisura jo më shumë se tre shtretër. Secila dhomë të ketë banjën e vet me ujë të ngrohtë gjatë gjithë kohës. Mbulesa të pastërta dhe të mjaftueshme. Darka: 20:00-21:00. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.

Dita dytë 20 shtator 2023;

- Mëngjesi në ora 07:00-08:30. Sipas menysë e cila rëndomtë shtrohet në mëngjes: Ushqim, pije të ngrohta dhe sasi e mjaftueshme e bukës.

- Vizitë: Nisja në ora 09:00 për në qytetin e Krujës, përkatësisht në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu", pagesa për hyrje bëhen nga kompania kontraktuese.
- Kthimi në hotel për drekë. Sasia e ushqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik. Vizitë Amfiteatrit të Durrësit. Darka: 20:00-21:00. Sasia e ushqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.

Dita tretë 21 shtator 2023;

- Mëngjesi në ora 07:00-08:30. Sipas menysë e cila rëndomtë shtrohet në mëngjes: Ushqim, pije të ngrohta dhe sasi e mjaftueshme e bukës.
- Vizitë në qytetin e Vlorës, përkatësisht në Shtëpinë e Pavarësisë. Nisja në ora 09:00. Pagesa për hyrje në Shtëpinë e Pavarësisë bëhet nga kompania kontraktuese.
- Dreka në Vlorë: Jo ushqim i shpejtë, por i njëjtë sikur në Hotelin e akomoduar. Pas dreke vizitë Kalas së Kaninës.
- Darka: 19:00-20:30. Sasia e ushqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.
- Mbrëmje argëtuese: 21:00-00:00. Muzikë live ose DJ sipas dëshirës së nxënësve. Mbrëmja mbaron në ora 00:00.

Dita katërt 22 shtator 2023;

- Mëngjesi në ora 07:00-08:30. Sipas menysë e cila rëndomtë shtrohet në mëngjes: Ushqim, pije të ngrohta dhe sasi e mjaftueshme e bukës.
- Dreka në hotel. Pas dreke në ora 13:00 vizitë qytetit të Tiranës, respektivisht Liqenit artificial. Pas kësaj vizite kthimi për Kosovë.

Bartja e nxënësve (afërsisht 330-367) bëhet me autobusë nga agjenci turistike sipas relacioneve të lartpërmendura, ndërsa akomodimi dhe qëndrimi bëhet në hotel (Durrës). Akomodimi gjatë qëndrimit përfshin: fjetjen, sigurinë fizike dhe shëndetësore (24 orëshe). Ushqimin cilësor, kalorik dhe i bollshëm.

Ndërkohë, agjencioni duhet t'i përmbahet të gjitha obligimeve që dalin nga UA 02/2016.

Hoteli duhet të jetë i përshtatshëm. Me jo shumë kate. Nëse ka më shumë se tri kate të posedojë ashensor. Stafi i Hotelit duhet të ketë uniformë apo shenjë me llogo të hotelit. Të njëjtit duhet të sigurojnë pastërti të ambientit ku qëndrojnë dhe argëtohen nxënësit. Hoteli duhet të sigurojë po ashtu çmime të njëjta të produkteve të tjera (pos atyre që janë në kontratë) me të njëjta çmime që janë edhe jashtë hotelit.